



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-145604
Më 14.10.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejin e mjeteve për përkrahje financiare për ShKA "Agimi" nga Prizreni, kryetari i Komunës, më 14 tetor 2014, miratoi këtë:

VENDIM

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejin e mjeteve për përkrahje financiare të ShKA "Agimi" nga Prizreni, me qëllim të organizimit dhe krenimit të përvjetorit jubilar të 70-të të themelimit të këtij subjekti kulturor, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet në lartësi prej 5000 €.
- II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve dhe atë:
 - a. Prej pozicioneve të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, lejohen mjetet në shumën prej 1000 €,
 - b. Prej pozicioneve të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, lejohen mjete në shumën prej 1000 €.
 - c. Prej pozicioneve të Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, lejohen mjetet në shumën 500 €, dhe
 - d. Prej pozicioneve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe pozicioneve të drejtorive të tjera komunale, lejohen mjete në shumën prej 2500 €.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Drejtorit e lartcekura dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-145607
Më 14.10.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për përkrahje financiare për KF “Liria”, kryetari i Komunës, më 14 tetor 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 7.10.2014, për përkrahje financiare për KF “Liria”, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për nevojat e klubit, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjete financiare në lartësi prej 9500 €.
- II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve të Komunës së Prizrenit.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
- IV. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, KF “Liria”, si dhe arkivi.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja